



revista

# Liberalale

Dhjetor 2025

## SELAMI XHEPA

Fillesat e transformimit të madh: 35 vite më pas

## ZEF PREÇI

kur filloi të matej ekonomia e tregut në shqipëri, ajo që na mungonte më shumë ishte njohuria për të

## HISTORIA E NJE MARKE

TCT, Nga kulla e Sahatit te qëllimi i profesionistëve të rinj

## 1 DITË KRYEMINISTËR

Gjergj Simaku: si "Kryeministër" do të anulloja çdo gjë që prish kokurrencën

# 2025, NË VITIN E 35-të, INDIKATORËT E KAPITALIZMIT SHQIPTAR

Nga viti 1990, kur nisën elementet e para të ekonomisë së tregut, deri në vitin 2025, kapitalizmi shqiptar ka prodhuar rritje ekonomike, pasuri private dhe integrim në tregjet rajonale, por ende nuk ka ndalur emigracionin masiv. Sfida e dekadës së ardhshme nuk është më kalimi në treg, por kalimi në një kapitalizëm produktiv e të qëndrueshëm. Ja analiza e ekspertëve



### 3 COVER

Në vitin e 35-të, një vështrim kritik mbi indikatorët e kapitalizmit Shqiptar (1991–2026)

### 8 ANALIZA

Fillesat e transformimit të madh: 35 vite më pas

### 11 INTERVISTA

Zef Preçi: Në vend të largimit, është e juaja sfidë për ta bërë Shqipërinë të jetueshme!

### 11 HISTORIA E NJE MARKE

TCT, Nga kulla e Sahatit te qëllimi i profesionistëve të rinj

### 16 1 DITË KRYEMINISTËR

Gjergj Simaku: Nëse do të isha kryeministër

revista  
**Liberales**

Revista Liberale është një projekt i Institutit Liberal të Tiranës, "Pashko", për të nxitur debatin mbi liberalizmin ekonomik në Shqipëri. Projekti i drejtuar nga Mateo Spaho dhe i mbështetur nga H.Ç. ENTERPRISE dhe UET PRESS



NGA MATEO SPAHO\*

**N**ë një shoqëri ku fjala “liri” shpesh përdoret si slogan politik, por rrallë përkthehet në politika reale, “Liberale” lind si një hapësirë mendimi që beson se individ - jo shteti, jo partia, jo turmat - është njësia themelore e shoqërisë.

Ne besojmë në liberalizmin politik, sepse pa institucione të forta, ndarje pushtetesh, sundim të ligjit dhe të drejta individuale të mbrojtura, demokracia mbetet një dekor formal. Ne besojmë në liberalizmin ekonomik, sepse prosperiteti nuk krijohet nga dekretet, por nga iniciativa private, konkurrenca e ndershme dhe tregu i lirë. Një shtet i fryrë që kontrollon gjithçka nuk prodhon drejtësi sociale, prodhon varësi, komplekson individët dhe bën që ekonomia të lëngojë. Nga krahu tjetër shteti duhet por për të patur rregulla të qarta për të gjithë si dhe për të garantuar sigurinë personale dhe kombëtare.

Kjo revistë nuk do të ofrojë dogma, por argumente. Revista Liberale është një hapësirë e hapur mendimi dhe debati, e krijuar për të ofruar ide, analiza dhe opinione mbi ngjarjet dhe vendimet kryesore që po formësojnë Shqipërinë dhe Botën. Ajo synon të nxisë reflektim kritik, dialog intelektual dhe pluralizëm pikëpamjesh, duke trajtuar zhvillimet politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në një kontekst kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes kontributeve nga autorë, studiues dhe profesionistë të fushave të ndryshme, Revista Liberale shërben si një platformë serioze për ide të reja, mendim të pavarur dhe diskutim të informuar mbi sfidat dhe drejtimet e së ardhmes.

Revista Liberale i mungon Shqipërisë sepse hapësira publike shqiptare ka një deficit të theksuar mendimi të thelluar, të pavarur dhe të argumentuar, përtej lajmit të shpejtë dhe polemikës së momentit. Debati publik dominohet shpesh nga reagime emocionale, interesat politike afatshkurtra dhe logjika e spektaklit mediatik, duke lënë pak vend për reflektim intelektual, analizë strukturore dhe ide afatgjata.

## Pse projekti revista “LIBERALE”? Sepse liria nuk është luks, është parakusht.

Një revistë liberale ofron atë që mungon: kohë për të menduar! Ajo krijon distancë kritike nga pushteti, nga opozita dhe nga narrativat dominante, duke u fokusuar te idetë, parimet dhe pasojat konkrete të vendimeve publike. Në një shoqëri në tranzicion të zgjatur si Shqipëria, ku institucionet janë ende të brishta dhe besimi publik i ulët, një hapësirë e tillë ndihmon në formimin e një kulture qytetare më të përgjegjshme.

Për më tepër, Shqipërisë i mungon një platformë që të lidhë mendimin shqiptar me debatin global, duke sjellë perspektiva ndërkombëtare dhe duke e vendosur vendin në rrjedhat e ideve bashkëkohore. Një revistë liberale nuk është thjesht media; ajo është një institucion i mendimit, që nxit pluralizmin, tolerancën dhe racionalitetin në debat, elementë këto, thelbësorë për një demokraci funksionale.

Ne këtë revistë do të shprehën akademikë dhe studiues (ekonomi, shkencë politike, sociologji, filozofi, histori, drejtësi) ekspertë dhe profesionistë (financë, biznes, teknologji, shëndetësi, mjedis), gazetarë dhe publicistë, politikëbërës dhe ish-zyrtarë, të rinj, studentë dhe doktorantë, me ese të strukturuar dhe ide origjinale. M.q.s. bota Shqiptare është gjithnjë e më e madhe, nuk do të mungojnë autorë nga diaspora shqiptare, që sjellin perspektiva krahasuese dhe zgjerojnë horizontet tona.

Në një kohë kur populizmi dhe etatizmi me anë të emocioneve, zëvendësojnë faktet, ku frika shitet si zgjidhje, Liberale zgjedh rrugën më të vështirë: lirinë me përgjegjësi. Sepse liria pa përgjegjësi është kaos dhe përgjegjësia pa liri është autoritarizëm.


Kjo revistë është për ata që besojnë se shoqëria përparon kur individët janë të lirë të mendojnë, të punojnë, të krijojnë (pse jo, dhe të gabojnë). Kjo është Liberale. Jo si ideologji e verbër por si bindje se një shoqëri e lirë është gjithmonë më e fortë se një shoqëri e kontrolluar.

*\*Drejtor i Institutit Liberal të Tiranës, “Pashko”*

# 25 LIBRA

## KUJTESA MBI KOMUNIZMIN

### 2009-2019



# NË VITIN E 35-TË, NJË VËSHTRIM KRITIK MBI INDIKATORËT E KAPITALIZMIT SHQIPTAR (1991–2026)

Kapitalizmi shqiptar ka prodhuar rritje ekonomike, pasuri private dhe integrim në tregjet rajonale, por ende nuk ka ndalur emigracionin masiv. Sfida e dekadës së ardhshme nuk është më kalimi në treg, por kalimi në një kapitalizëm produktiv e të qëndrueshëm



NGA MATEO SPAHO

**N**ë vitin 2026, Shqipëria shënon 35 vjet nga nisja e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Është një përvjetor simbolik jo vetëm për ndryshimin e sistemit politik, por për lindjen, rritjen dhe transformimin e kapitalizmit shqiptar. Një kapitalizëm i ndërtuar shpejt, pa dijeni të trashëguara, shpesh në kushte kaotike, me fitore të rëndësishme, por edhe me kosto të larta sociale e me institucione problematike.

Vitet e para të pas-komunizmit u karakterizuan nga një kalim brutal nga ekonomia e planifikuar në tregun e lirë. Privatizimi masiv i ndërmarrjeve shtetërore, liberalizimi i çmimeve dhe hapja e tregtisë ndodhën më shpejt se ndërtimi i institucioneve. Ligji 7501 mbi tokën dhe lejimi i shkatërrimit të infrastrukturës industriale janë plage që vendi po i ndjen ende sot. Biznesi shqiptar i kësaj periudhe ishte kryesisht mikro-biznes familjar, tregti e vogël, shërbime bazike dhe aktivitet informal. Shteti ishte i dobët, rregullimi minimal dhe ekonomia funksiononte më shumë mbi instinktin sesa mbi rregulla. Rënia e skemave piramidale në vitin 1997 ekspozoi qartë mungesën e mbikëqyrjes financiare dhe një kapitalizëm të pa-ankoruar në institucione. Pas krizës së 1997-s, Shqipëria hyri në një periudhë stabilizimi makroekonomik. Inflacioni u kontrollua, sistemi bankar u rindërtua dhe u hap. Lindën kompanitë e sigurimeve, tregu mediatik dhe u krijuan bazat e një shteti funksional. Kapitalizmi shqiptar filloi të marrë formë më klasike: ndërtim, shërbime, financa, tregti me pakicë dhe investime të para të huaja.

Biznesi u formalizua gradualisht, por mbeti i fragmentuar dhe me produktivitet të ulët. Ndërtimi u shndërrua në motorin kryesor të rritjes ekonomike, ndërsa remitancat nga emigrantët u bënë burim kyç financimi. Shteti luajti një rol më të qartë si rregullator, por shpesh selektiv dhe i politizuar. Në vitin 2005, në Shqipëri, rezultoni vetëm 384 biznese me më shumë

se 50 të punësuar, ose biznese të mëdha dhe zyrtarisht ishin të punësuar vetëm 400 mije persona (nga të cilët 175 mije në shtet) ndërkohë që 600 mije të tjerë ishin informal.

Me kalimin e viteve, në mënyrë progresive u rrit numri i bizneseve, fushat ku ato vepronin dhe paralelisht u zvogëluan ndërprerjet e energjisë elektrike, u rrit furnizimi me ujë dhe vendi pati një rritje të ndjeshme të ri-ndërtimit infrastrukturor (rrugë, aeroporte, porte, ujësjellësa, kanale vaditëse e kulluese), duke e bërë vendin më të aksesueshëm dhe të vizitueshëm nga investitorët e huaj dhe emigrantët Shqiptarë. Niveli i aktiviteteve kriminale dhe informaliteti u reduktuan dhe si pasojë stabiliteti i vendit u rrit. Hyrja në NATO dhe liberalizimi i vizave ishin në të njëjtën kohë një rezultat i këtyre arritjeve dhe një themel për një mjedis më të favorshëm për një rritje ekonomike të mëtejshme. Kriza globale financiare e vitit 2008 nuk e goditi drejtpërdrejt Shqipërinë, gjithsesi ajo nxori në pah dobësitë strukturore të modelit ekonomik. Rritja vazhdoi, por e mbështetur kryesisht në ndërtim, konsum dhe shpenzime publike, jo në industri apo inovacion.

Bizneset e mëdha filluan të konsolidohen, ndërsa u krijua një hendek i qartë mes ndërmarrjeve të vogla dhe një grupi të kufizuar kompanish me akses në kapital, tenderë dhe tregje. Kapitalizmi shqiptar u bë më i organizuar, por jo domosdoshmërisht më konkurrues. Në vitin 2013 bizneset e mëdha rritën në 1138 dhe te punësuarit zyrtarë u rritën me 25% në raport me vitin 2005.

Pandemia COVID-19, tërmeti i vitit 2019 dhe tensionet globale testuan rezistencën e ekonomisë shqiptare. Shteti u rikthye si aktor aktiv përmes ndërhyrjeve fiskale, subvencioneve dhe investimeve publike, duke rritur ndjeshëm borxhin publik.

Në të njëjtën kohë, u përshpejtuan disa trende strukturore pozitive si digitalizimi i shërbimeve, rritja e turizmit si pasojë e përmirësimit të imazhit të vendit dhe të



ndërhyrjeve konkrete në infrastrukture dhe në aredimin urban. Kjo solli edhe rritjen e mëtejshme të sektorit të ndërtimit gjatë bregdetit si dhe në aksin Tiranë-Durrës. Shqiptarët sot gëzojnë dhe vuajnë nga rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme. Sektorit bankar dhe financiar u konsolidua dhe më tej e me të ka filluar edhe rritja e sektorit të teknologjisë së informacionit. Kapitalizmi shqiptar sot është më i sofistikuar se kurrë më parë! A mjafton kjo? Natyrisht Jo!

Bujqësia shqiptare në vitet 2024–2025 paraqet një situatë kontradiktore: ajo mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm për punësimin dhe sigurinë ushqimore të vendit, por njëkohësisht është sektori më pak produktiv dhe më problematik. Aktualisht, bujqësia kontribuon rreth 15% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe në teori punëson afërsisht 30–31% të forcës së punës, në praktikë më shumë se gjysma e të punësuarve kanë emigruar jashtë shtetit. Struktura e fermave përbën një nga problemet kryesore. Madhësia mesatare e fermës është rreth 1.2 hektarë dhe toka është e fragmentuar në disa parcela të vogla, çka e bën të vështirë mekanizimin, modernizimin dhe certifikimin për tregjet e huaja. Si pasojë,



shumica e fermave funksionojnë në nivel familjar. Prodhimi bujqësor karakterizohet nga rendimente relativisht të ulëta dhe konkurrohet nga produkte të huaja të subvencionuara nga vendet e origjinës. Shqipëria ndonëse eksporton produkte si perime të freskëta, bimë mjekësore dhe vaj ulliri, por mbetet shumë e varur nga importet ushqimore, duke krijuar një deficit të thellë tregtar. Problemet e ujitjes, ndryshimet klimatike dhe infrastruktura e amortizuar e rëndojnë më tej situatën. Financimi bankar për bujqësinë është i kufizuar, ndërsa politikat mbështetëse shpesh janë të fragmentuara dhe tërësisht të pa mjaftueshme. Pa konsolidim të pronësisë së tokës, investime në agro-industri dhe orientim drejt zinxhirëve të vlerës, sektori rrezikon të mbetet një barër apo frenë për transformimin ekonomik afatgjatë të vendit.

Industria shqiptare përballet me një sërë problemesh strukturore dhe ciklike, të cilat e kanë penguar të shndërrohet në një motor të qëndrueshëm të rritjes ekonomike. Megjithatë kontributi i saj në Prodhimin e Brendshëm Bruto është rritur lehtë vitet e fundit, industria mbetet e fragmentuar, me vlerë të shtuar të ulët dhe të varur nga faktorë të jashtëm si luhatjet

e çmimeve të energjisë, kursi i këmbimit, inflacioni dhe ndryshimet në kërkesën e tregjeve të huaja. Pjesa më e madhe e aktivitetit industrial përqendrohet në fasoneri, përpunim të thjeshtë ushqimor dhe materiale ndërtimi. Këto aktivitete janë intensive në punë, por me teknologji të ulët dhe marzhe të kufizuara fitimi, duke e bërë sektorin pak konkurrues. Produktiviteti i ulët është një tjetër sfidë madhore. Mungesa e investimeve në teknologji, automatizim dhe kërkim-zhvillim (R&D) bën që prodhimi për punonjës të jetë dukshëm më i ulët se në vendet e BE-së dhe rajonit. Kjo lidhet drejtpërdrejt me kapitalin e kufizuar, qasjen e vështirë në financim dhe koston relativisht të lartë të energjisë për industrinë.

Industria shqiptare tashmë vuan edhe gjithashtu nga mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar. Emigracioni, plakja e popullsisë dhe mos-përputhja mes arsimit profesional dhe nevojave të tregut kanë krijuar mungesa serioze në profile teknike dhe inxhinierike, duke rritur kostot për bizneset.

Infrastruktura dhe logjistika mbeten pengesë. Transporti i brendshëm, lidhjet hekurudhore të dobëta dhe kostot e larta të logjistikës ulin konkurrueshmërinë e

produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Kjo situatë rëndohet nga procedurat administrative, informaliteti dhe korrupsioni që mbeten ende problematik.

Në 35 vjet, shteti shqiptar ka kaluar nga pothuajse nga një mungesë totale të një prani e fortë në ekonomi. Problemi nuk është më mungesa e shtetit por cilësia e tij: kapacitetet institucionale, transparencja, konkurrenca e ndershme dhe barazia para ligjit.

Kapitalizmi shqiptar ka prodhuar rritje ekonomike, pasuri private dhe integrim në tregjet rajonale, por ende nuk ka ndaluar emigracionin masiv. Sfida e dekadës së ardhshme nuk është më kalimi në treg, por kalimi në një kapitalizëm produktiv e të qëndrueshëm.

Por gota nuk duhet parë vetëm gjysmë bosh!

Në vitin 1991 një shqiptar kishte rreth 200 dollarë në vit të ardhura për frymë dhe nga 187 shtete ishte në pozicionin e 184. Kjo do të thotë se veç tre vendeve të Afrikës, gjithë shtetet e tjera kanë qenë më mirë se ne! Në fundin e vitit 2025 të ardhurat për frymë kanë qenë rreth 13.100 dollarë duke e vendosur Shqipërinë në vendin 104 nga 218 shtete, duke lënë pas vende si Moldavia, Kosova, Bosnja dhe se fundmi Maqedoninë e Veriut!

Kjo është meritë e kapitalizmit Shqiptar, që sot numëron me shume sa 2000 biznese të mëdha ( mbi 50 të punësuar) dhe punëson mbi 570 mijë persona nga 750 mijë të punësuar zyrtarisht. Kapitalizmi Shqiptar sot prodhon mbi 30 miliard dollarë çdo vit dhe shteti Shqiptar merr nga këto biznese mbi 9 miliard për të krijuar "Buxhetin e shtetit". Investimet e Huaja Direkte kanë arritur nivelin e 1.8 miliard dollarë në vit. Paga mesatare sot ka tejkaluar masën e 1000 dollarë në muaj (50 herë më shumë se në vitin 1991) dhe fuqia blerëse e tyre në këto 35 vite është 20-fishuar. Kjo do të thotë se kapitalizmi, edhe ai Shqiptar, nuk i bënë mirë vetëm pronarëve!

Përpara kapitalizmi dhe ekonomia Shqiptare kanë plot sfida, por nuk ka vend për pesimizëm!



# FILLESAT E TRANSFORMIMIT TË MADH: 35 VITE MË PAS

NGA SELAMI XHEPA



**P**ara vitit 1990, Shqipëria praktikisht nuk kryer asnjë reformë ekonomike, as të tipit që shumë nga ish vendet komuniste kishin ndërmarrë që nga mesi i viteve 1970. Mekanizmi i ri ekonomik (një lloji autonomie më e madhe e ndërmarrjeve) që u ndërmor në fundin e viteve 1980, ishte krejt e pamundur për të mbajtur nën kontroll disbalancat serioze që ishin thelluar gjatë asaj dekade. Gjithashtu, Shqipëria do të ishte i fundit ndër vendet ish-komuniste që lejoji pluralizmin

politik dhe nisi transformimet demokratike dhe të instalimit të ekonomisë së tregut. Me një ekonomi të rrënuar për shkak të modelit që kishte zbatuar dhe një shoqëri që kishte prekur nivelet e mjerimit, zgjedhjet politike ishin mjaft të kufizuara. Në një kuptim, ajo që njihet tashmë si “terapia e shokut” nuk ishte aq shumë një zgjedhje më shumë se sa një imponim i diktuar nga kushtet e nisjes së reformave. Parametrat kryesorë makroekonomik ishin destabilizuar: prodhimi i përgjithshëm kishte rënë me 1/3 (30%-40% sipas vlerësimeve të FMN); inflacioni që shoqëroi liberalizimin e çmimeve në mesin e vitit 1992 u ngjit në 226%, me një nivel të prodhimit për frymë ndër më të ulëta në botë, vlerësuar në rreth 320 \$/frymë (nga 623\$ që ishte në vitin 1990), kursi i këmbimit të monedhës kombëtare, lek, fillimisht u fiksua me një çmim 30 lek/1 ECU ose 25 lek/1 USD, por kursi këmbimit në tregun paralel ishte shumë më i lartë, duke bërë





















që monedha të zhvlerësohej zyrtarisht në 50 lekë/1USD dhe më vonë u kalua drejt kursit luhatës të këmbimit; disbalancat fiskale kishin filluar të akumulohen që nga mesi viteve 1980 dhe deficit fiskal në vitin 1990 llogaritej në 16.6% të prodhimit të brendshëm. borxhi i jashtëm që kishin akumuluar ish ndërmarrjet e tregtisë së jashtme llogaritej në 30% të prodhimit të brendshëm, dhe në kushtet kur rezerva valutore kishte rënë në gati 15 milionë dollarë, praktikisht vendi u fut në një krizë të borxhit të huaj që do të zgjidhej më vonë përmes Klubit të Parisit. (Shënim: të gjithë të dhënat janë marrë nga IMF, 1992, Occasional Paper/98).

Thënë shkurt: vendi kishte falimentuar në kuptimin ekonomik dhe vetëm përmes reformave politike mund të kërkoheshin zgjidhje të reja bazuar në një model të ri ekonomik. Filozofia mbi të cilën do të mbështeteshin reformat e tranzicionit, do të formulohej në atë që njihet si “Washington Consensus” dhe që përmbledhet në trinomin: stabilizim markoekonomik - liberalizim/derregullim - privatizim. Përtej debateve ideologjike, siç edhe nënvizova më lart, zgjedhjet e alternativave politike ishin kryesisht të diktuar nga konteksti i disbalancave makroekonomike që përmendëm. Duhet theksuar gjithashtu se Shqipëria ishte ndër ekonomitë e para të tranzicionit që e rikuperoi “gropën” që ishte krijuar nga shembja e sistemit komunist brenda një dekade. Në vitin 2000, prodhimi i brendshëm kishte kaluar nivelet e vitit

1992 dhe parametrat kryesore makro-ekonomik ishin stabilizuar. 35 vite më pas, Shqipëria ka arritur të ndërtojë një ekonomi që prodhon 32.4 miliardë dollarë, me çmimet korente, (ose 66.3 miliardë dollarë sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse) mallra dhe shërbime, që konvertohet në një prodhim për frymë prej mbi 12 mijë USD (ose rreth 25 mijë dollarë, sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse). Me inflacionin nën kontroll (2-3%) dhe borxhin publik aktualisht (2026) në 52.7% të prodhimit të brendshëm, dhe një deficit të llogarisë korrente prej -2.7% të prodhimit të brendshëm, fundamentet ekonomike janë të shëndetshme. Por, konteksti i ri ekonomik e politik i botës së sotme kërkon një rikonsiderim të paradigmës së krijuar nga Washington Consensus, duke përfshirë element të rinj në premisat e politikave të reja që duhen zbatuar. Kuptimi më i gjerë i volatilitetit makroekonomik, qëndrueshmëria (resilience), zbutja e pabarazive përmes një qasje të re të pre-distribution krahas fuqizimit më të fortë të instrumenteve tradicional të rishpërndarjes përmes politikave fiskale, politika aktive publike në zhvillimin ekonomik (strategjitë industriale dhe teknologjike), kërkojnë një rol më aktiv të shtetit. Rritja e rolit të shtetit kërkon ndërtimin e tij dhe të institucioneve, duke e konsideruar atë si infrastrukturën bazë të shoqërisë. Pa një shtet të fortë dhe eficient, as tregjet nuk mund të ekzistojnë dhe të jenë efiente. Selami Xhepa President, UET

# 25 LIBRA BIOGRAFI



# ZEF PREÇI: KUR FILLOI TË MATEJ EKONOMIA E TREGUT NË SHQIPËRI, AJO QË NA MUNGONTE MË SHUMË ISHTE NJOHURIA PËR TË

Ekspteri i njohur i ekonomisë Zef Preçi në një bashkëbisedim me maturantët, në kuadër të takimit të përvitshëm të Rrethit Liberal të Dardhës, “një shoqëri që nuk proteston është e destinuar të dështojë”

**M**es informacioneve, analizave të thelluara dhe këshillave të çmuara profesionale u zhvillua bashkëbisedimi i maturantëve me Zef Preçin, një prej ekspertëve më të njohur të ekonomisë në Shqipëri. Diskutimi erdhi në kuadër të takimit të përvitshëm të Rrethit Liberal të Dardhës, zhvilluar në datat 12-14 dhjetor.

Gjithmonë në fushën e ekonomisë, por asnjëherë vetëm ekonomist. Zef Preçi ka qenë më shumë duke vendosur në gjithçka syrin dhe analizën e një studiuesi. Kjo edhe për shkak të punës së tij të parë pranë Akademisë së Shkencave, ku librat i injektuan skrupuliozitetin e një kërkuesi shkencor, tipar që e karakterizoi dhe e shoqëroi në vitet e mëvonshme.

Të jetuarit në dy kohë, në dy sisteme të ndryshme e ka bërë njohës të mirë të funksionimit të parametrave ekonomikë. Nëse në të parin ishte vetëm në rolin e studiuesit dhe zbatuesit, sistemi i ekonomisë së tregut i ofroi mundësinë të jetë faktor dhe aktor në vendimmarrje, si pjesë e sistemit bankar, ish-ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, pjesë e Presidencës dhe më tej titullar në Kuvend. “Prej 2005-ës jam shkëputur përfundimisht nga sektori publik”, tregoi Preçi gjatë intervistës kolektive me maturantët në takimin e Rrethit Liberal të Dardhës, zhvilluar në datat 12-14 dhjetor 2025.

**Zoti Preçi, a mund të themi se ishte e përgatitur shoqëria shqiptare për të kuptuar dhe më tej për të kaluar në një ekonomi konkurruese, të tregut të lirë, pas rënies së komunizmit?**

Jo, ekonomia e Shqipërisë në vitin 1991 ishte e papërgatitur për hapje të plotë ndaj tregjeve globale, pasi po dilte nga izolimi ekstrem me një sistem të deshtuar dhe



të planifikuar në mënyrë qendrore, duke u përballur me varfëri, infrastrukturë të vjetëruar dhe mungesë institucionesh tregu, por tranzicioni filloi në vitin 1991 me hapa të rëndësishëm ligjorë si liberalizimi i tregtisë dhe lejimi i sipërmarrjes private, i mbështetur nga ndihma

perëndimore për të lehtësuar këtë ndryshim të dhimbshëm, por të domosdoshëm.

***Cila është baza më e fortë e ekonomisë në Shqipëri, cilët janë sektorët ku mbështet rritja ekonomike?***

Nëse i referohemi ku kemi qenë dhe ku jemi nuk ka të krahasuar. Do të thotë që kemi zhvillim. Të krahasohesh në raport me mundësitë që janë krijuar në 35 vjet, nuk kemi bërë mjaftueshëm. Nuk jemi aty ku duhet të jemi. Baza ekonomike është identifikuar prej 30 vjetësh, që nga viti '94- '95, që potencialet zhvillimore të këtij vendi kanë lidhje me bujqësinë dhe turizmin. Ajo që ndodh sot me turizmin masiv është shumë e kritikueshme dhe shumë kërcënim për degët e tjera dhe për zhvillimin në tërësi. Thuhet që kanë hyrë 4 miliardë euro nga turizmi vitin e kaluar, 15 milionë turistë janë raportuar. Po të shohësh paratë e shpenzuara nga shqiptarët për turizëm jashtë vendit janë 2.8. Domethënë, çfarë mbetet në ekonomi, s'po them për impaktin tek mjedisi, s'po them për infrastrukturën etj.

***Edhe dy degët kryesore të zhvillimit të ekonomisë shqiptare mbeten problematike. Çfarë duhet bërë që ato të performojnë si duhet dhe në rritje?***

Potencialet mbeten në bujqësi dhe turizëm, por mendoj se ka nevojë për një strategji, e cila harmonizon turizmin masiv me turizmin elitare dhe njëkohësisht vendos infrastrukturën tjetër në shërbim. Në qoftë se do të kishim vërtetë impakt të turizmit, do të kishim rritje të prodhimit vendas, do të kishim furnizim më të mirë të tregut. Çmimet rriten, është e natyrshme sepse rritet konsumi. Fakti që ne na është pakësuar në harkun e 10 viteve me 1/4 numri i lopëve, deleve, dhive e të tjerë, pra kafshëve të prodhimit, dëshmon që ka një handicap shumë të madh kur sektorët e ekonomisë nuk ndërveprojnë midis tyre dhe mungojnë politikat që e lehtësojnë. Roli i shtetit është të krijojë politikat, të krijojë mjedisin, të krijojë klimën e biznesit, jo të zgjidhë problemin. Problemin e zgjidh sipërmarrësi, e zgjidh privati.

***A mendoni ju se Shqipëria ka potencial në pjesën e zhvillimit të industrisë së re?***

Fakt është që potenciali, unë besoj te kjo, është te agropërpunimi, një fushë që mund të ndihmonte për të harmonizuar njëkohësisht interesin e fermerit. Neve na ka ndodhur proletraizimi i fshatit, se po vazhdoi me këto ritme për katër pesë vjet, s'ka më fshatar.

Jemi të gjithë në qytet, të gjithë të varur nga importi edhe toka djerrë, në një kohë që kinezët dhe izraelitët po gjelbërojnë shkretëtirën. Industria e lehtë dhe ushqimore mund të ishte një potencial në funksion të mundësive që ka vendi dhe njëkohësisht furnizon më mirë turizmin, i cili po ashtu mbetet i rëndësishëm.

***Mendoni që edhe në ditët e sotme ka akoma individë të cilët nuk presin që këto probleme ekonomike të zgjidhen nga të tjerët, por marrin iniciativën?***

Ajo që unë ajo që unë thashë edhe e përsëris është entrepreneurial spirit (shpirti i sipërmarrjes) na bën krenar, është për t'u vlerësuar. Në të njëjtën kohë, përpjekja për t'i zgjidhur vetë problemet ë mënyrë të pakoordinuar pa vlera komunitare, pa vlera fetare, ndoshta dhe me vlera kombëtare të diskutueshme, është një pikëpyetje e madhe sepse vendet e tjera kanë ecur duke marrë përgjegjësi individë edhe njëkohësisht duke reaguar si komunitet. Për fat të keq ne nuk e kemi këtë veçori që është edhe shtrati ku ngjizet keqqeverisja. Kështu që përpjekja e individit për t'i zgjidhur problemet vlen nëse shkon përmes vijave të bardha. Përndryshe ndodh si me ndërtime të paligjshme që secili zë tokën, e cila është pasuria e brezave, e kombit, jo vetëm e atij që disponon në një periudhë kohe të dhënë.

***Sot është një situatë ku ekonomia dhe shoqëria janë sfiduar nga zhvillimet e natyrave të ndryshme, por teknologjia është qendrore. Zhvillimi teknologjik ose AI-ja, çfarë impakti do të kenë në botën e punës dhe të biznesit?***

Duam apo s'duam ne, robotizimi, përdorimi i teknologjisë bashkëkohore, IT-ja është diçka që ka filluar si hobi dhe është i domosdoshëm. Sot nuk mund të imagjinohet dikush që s'ngjet makinën, dikush që nuk zotëron gjuhën e huaj, dikush që nuk përdor teknologjinë në një standard. Ata që duan të bëjnë diferencën do duhet t'iu kushtojnë më shumë kohë, më shumë përpjekje, sepse ky treg sot është plotëson disa nevoja, nesër ka me qenë më konkurrues. Po të vini re në 10 vitet e fundit janë dhjetëra kompani të huaja italiane, greke, gjermane kanë ardhur këtu dhe kanë rekrutuar që studentë më të mirë e mundshëm. Tani ata që janë rekrutuar para pesë vitesh, para shtatë vitesh, shkojnë në një stad më të lartë dhe tregu vazhdon e bëhet më konkurrues. Kjo do të thotë që konkurrenca do çojë në përmirësim cilësor, pra identifikim të individëve më të avancuar edhe në të njëjtën kohë nuk do të jetë më ajo joshje me pagat që ka qenë në fillim.

***Nëse një i ri si unë ju drejton pyetjen se në cilin sektor ia vlen t'i investoj kursimet e mia, ju çfarë do t'i këshillonit?***

Unë nuk mund të jap këshillë se çfarë mund të bëjë dikush që ka para sepse ajo është vendimmarrje për risk, por ajo që mund të them është që mos i mbaj të gjitha vezët një në një shportë, shprehje që i atribuohet autorit të "Don Kishotit", Miguel de Cervantes. Përpiquni jo të kurseni. Në Shkodër, në periudhën e regjimit të Mbretit

Zog qarkullonte shprehja ta pafsha pasurinë, lekë, monedhë. Ishte mallkim. Nuk do të thosha që kurseni, por merrni vendime në bazë të një racionaliteti ekonomik që merr në konsideratë burimet, nevojat prioritare edhe njëkohësisht risqet.

***Më mirë të studiosh ekonomi apo të ndërtosh biznesin dhe sipërmarrjen tënde?***

Më thotë dikush një ditë: “Si e shpjegon që shumica e atyre që s’kanë bërë shkollë janë të suksesshëm në biznes?” Unë nuk mendoj kështu. Ajo është një vendim-marrje individuale. Duhet pranuar që shkolla bëhet kur ke moshën, kur ke shëndetin, kur ke rrethanat, kur ke nevojë për të. Nuk është qëllim në vetvete. Ju duhet të çliroheshi nga mentaliteti i prindërve dhe i yni, që nëse ke një diplomë në xhep ke fituar të drejtën të jetosh më mirë. Është potenciale, është e mundshme, por ka plot njerëz, që edhe pse kanë bërë shkollën, janë marrë me biznes dhe janë po aq, në mos më të suksesshëm sesa po të ishin në profesionet për të cilat janë diplomuar. Kështu që, nuk mund të ketë një zgjidhje apo një rekomandim për këtë. Secili vepron në rrethana të caktuara, në një kontekst social, ekonomik, juridik, shoqëror, familjar dhe në këto kushte merr dhe vendimet përkatëse. Asnjëherë nuk ka keq nga dija. Mos e shkëputni librin dhe mos mendoni se po morët diplomën, ju zotëroni dhe dini gjithçka. Duhet pafundësisht të studioni dhe pafundësisht të adoptoheni, të akomodoheni me çfarë ndodh, me politikat që ndiqen e të tjerë.

Nuk është thjesht si termi politik, njerëzit e ngatërrojnë me partishmërinë. Ajo është pjesë tjetër, për të cilën vlen thënia e atij filozofit francez që thotë: “Ju mund të mos merrni politikë, s’ka problem. Merret politika me ju”. Por, në atë fushë interesi ku ju zgjidhni për të për të punuar, përpiquini të jeni të përditësuar, të apdejtuar me zhvillimet edhe njëkohësisht të merrni përgjegjësi.

***Nëse bëni një krahasim me të rinjtë, studentët e '90-ës dhe të rinjtë e sotëm, a mendoni se kanë të njëjtin motivim dhe “uri” për të sjellë ndryshim, në kuadër të vetëreformimit të shoqërisë shqiptare?***

Shqetësimi im më i madh është se shoh një pjesë të mirë të brezit të ri që është apatik. Natyrisht ne kemi qenë të përgjumur sepse ishim si qen të rrahur në kuptimin e mirë të fjalës. Kjo vinte për shkak të rrethanave. Prindërit tanë na kanë thënë mos u merrni me politikë, rrini larg, mos u përzieni, në qoftë se është dikush me biografi të keqe rri larg tij. Ti mund të kishë simpati apo respekt, por duhet të ruheshe nga publiku sepse ashtu funksiononte shoqëria.

Pas 35 vitesh, kur pluralizmin politik e kemi marrë gratis, ky popull nuk ia prerë kokën mbretit asnjëherë,

ka qenë një vendim-marrje për shkak të rrethanave ndërkombëtare, që Byroja Politike, ende në pushtet, u dorëzua dhe pranoi sistemin kapitalist. Kjo është marrë for grant-ed edhe këtë s’duhet ta shpërdorjmë. Njerëzit duhet të ndjehen të përgjegjshëm, reagues karshi zhvillimeve që ndodhin edhe në të njëjtën kohë të kultivojë vlera komuniteti. Mua më ka ngelur në mendje që vite përpara, lëvizja në Itali “Cinque Stelle”, thjesht me kontakte në rrjetet sociale, pa median, arriti të bëhet faktor dhe është e tillë edhe sot në parlament.

Shfrytëzoni avantazhet që u ofron koha. Teknologjia është një avantazh i madh edhe njëkohësisht dilni nga Facebook-u. Mos mendoni që duke shprehur një opinion në Facebook keni mbërritur një audiencë të caktuar apo jeni bërë interesantë. Mësoni të reagoni dhe format e reagimit janë nga më të ndryshmet. Unë nuk shoh të bëhet një peticion, nuk shoh të ketë një reagim.

Dy protesta mbaj mend në periudhën e 30 viteve të fundit. Protestën për armë kimike, një element qytetarie që bashkoi pa dallim ngjyre partie, preference, moshe e të tjera. E dyta ishte protesta e studentëve që u shua thjesht me disa ndryshime në kabinet.

Një shoqëri që nuk proteston është destinuar të dështojë. Protestën dhe mendimin kritik duhet ta keni pjesë të së përditshmes. Dyshoni për gjithçka, nuk ka asgjë të keqe. Besimi ndërtohet kur ti e njeh dhe vërtetë e beson, jo kur e merr të mirëqenë gjithçka që qarkullon.

***Jemi të gjithë maturantë dhe duhet të marrim një vendim për shkollimin dhe të ardhmen, duke iu përgjigjur edhe dilemës nëse duhet të emigrojmë apo të rrimë në Shqipëri. Ju si e lexoni fenomenin e shpopullimit të Shqipërisë?***

Nuk duhet të keni kurrfarë dyshimi që të jetosh në Shqipëri do të thotë të marrësh përgjegjësi edhe njëkohësisht ta ndërtosh të ardhmen tënde këtu. Vajzat e mia kanë ikur në moshë të madhe, pas universitetit, kanë shkuar për specializimet dhe pastaj s’janë këtu më. Ato janë më të azhurnuara me çfarë ndodh këtu sesa jam unë. Pra mbeten me kokën pas. As nuk janë qytetare gjermane, edhe pse kanë shtetësinë. As nuk janë qytetare shqiptare, janë të huaja dhe atje dhe këtu. Mezi presin të vijnë katër-pesë herë në vit. Natyrisht fëmijëve u kanë mësuar shqip unë bëj çmos që të vijnë se mundohem t’ju mbaj gjallë ndjenjën kombëtare. Dashur pa dashur është një kryqëzim kulturash, por në thelb nuk është vlerë e shtuar.

Përpiquini ta ndërtoni të ardhmen këtu. Në fund të fundit, në qoftë se do të kishte debat publik në këtë vend, duhet të jetë për dekurajimin e braktisjes së Shqipërisë. Kjo do të ishte sfida e juaj si brez për ta bërë Shqipërinë të jetueshme.

# TCT, NGA KULLA E SAHATIT TE QËLLIMI I PROFESIONISTËVE TË RINJ

I nisur prej vitit 2015, Tirana Colege Technology është shndërruar tashmë në një institucion të përgatitjes dhe zhvillimit profesional dhe me ide të qarta drejt së ardhmes.

**T**irana Colege Technology është krijuar si një mision për të përgatitur të rinjtë në tregun e punës por edhe në profesionet më të kërkuara në Shqipëri por edhe jashtë. Megjithatë ndërtimi me profesionistë i një sistemi të tillë arsimor kërkon së pari një ide të qartë të prezantimit e këtu diskutimi nis që prej Markës.

TCT në formën e vet prezanton gjithçka që kërkohet në idenë e një shkolle profesionale. Instrumentet matëse, që përcaktojnë disiplonë e saktësinë, një gjuhë gjeometrike të pastër por dhe simbolin e Tiranës, Sahati.

Në intervistën për revistën Mapo, Gerton Bejto tregon momentet e para të diskutimit për te idetë e hedhura dhe se përse u arrit në të. Diskutimi për logon, thotë ai, nisi nga ideja nga fokusi që do të kishte Kolegji, e pak nga pak gjithçka nisi të thuret në imazhin që prezanton sot TCT një nga markat më të njohura sot. “Edhe pse logojta paravizualizon siluetën e Kullës së Sahatit, ajo nuk është ndërtuar si një formë statike. Përkundrazi, struktura e saj përbëhet nga linja dinamike dhe kënde të prepra, të cilat krijojnë ndjesinë e lëvizjes dhe progresit”, thotë ndër të tjera. Por logo duhet të mbështetet në ngjyja që të shprehin qartë atë çfarë përfaqëson. Ndaj dhe tonaliteti i fortë dhe energjik i përzgjedhur për këtë logo komunikon vendosmëri, punë dhe dinamizëm, ndërsa kontrasti i pastër siguron lexueshmëri dhe forcë vizuale. Gjithçka që të përfaqësojë kolegjin duke frymëzuar të rinjtë me dinamikën dhe energjinë që u duhet.

Madje Bejto thotë se diskutim pas diskutimi dhe hap pas hapi u krijua një logo e cila jo vetëm që i ka rezistuar kohës dhe ka gjetur vendin e duhur, por po ashtu do të rezistojë gjatë në kohë.

“Logoja përputhet me vizionin e së ardhmes që u kërkua që në hapat e parë të projektit. Ajo është ndërtuar si një sistem vizual fleksibël dhe i adaptueshëm për media dhe kanale të ndryshme komunikimi, sot dhe në



të ardhmen”, thotë duke shtuar se çdo përmirësim i mundshëm do të jetë evolutiv dhe funksional, pasi baza konceptuale e logos është e fortë dhe e qëndrueshme.

#### **Cili është kuptimi i logos TCT, a ka një domethënie të caktuar?**

Logoja e TCT mbart një domethënie të qartë dhe të ndërtuar konceptualisht. Ajo buron nga mjetet bazë të një shkolle teknike – instrumentet matëse, kompasit dhe rapidografi – të cilat përfaqësojnë saktësinë, disiplinën dhe dijen praktike. Përmes një gjuhe gjeometrike të pastër, këto elemente bashkohen për të ndërtuar siluetën e Kullës së Sahatit të Tiranës, një simbol historik dhe urban që lidh institucionin me qytetin, kohën dhe vazhdimësinë.

#### **Si u arrit në këtë format, ishte një bashkim idesh i thurur më tej në imazh?**

Logoja është rezultat i një procesi të strukturuar kërkimi dhe krijimi. Fillimisht u analizuan mjetet dhe parimet e arsimit profesional, më pas këto ide u përkthyen në forma gjeometrike të sakta dhe proporcionale. Instrumentet teknike u trajtuan si elemente ndërtuese, të cilat përmes një sintheze vizuale krijojnë një formë të vetme vertikale. Imazhi final rrëfen kalimin nga matja dhe projekti, drejt ndërtimit dhe identitetit.

#### **Janë ide që shkojnë me misionin?**

Po, idetë e mishëruara në logo janë në përputhje të plotë me misionin e Kolegjit Profesional të Tiranës. Edhe pse logoja paravizualizon siluetën e Kullës së Sahatit, ajo nuk është ndërtuar si një formë statike. Përkundrazi, struktura e saj përbëhet nga linja dinamike dhe kënde të prera, të cilat krijojnë ndjesinë e lëvizjes dhe progresit. Kjo dinamikë vizuale pasqyron arsimin profesional si një proces aktiv, në zhvillim të vazhdueshëm, dhe simbolizon tranzicionin nga teoria në praktikë, nga ideja në veprim.

#### **Cila është domethënia e ngjyrave, kombinim, rastesi apo e mirëmbuar?**

Zgjedhja e ngjyrës është e mirëmbuar dhe funksionale. Tonaliteti i fortë dhe energjik komunikon vendosmëri, punë dhe dinamizëm, ndërsa kontrasti i pastër siguron lexueshmëri dhe forcë vizuale. Në veçanti, portokallia e zgjedhur është një ngjyrë dinamike, e mbushur me energji, që reflekton jo vetëm vizionin e institucionit, por edhe proceset aktive të të mësuarit, ndërtimit dhe krijimit. Ajo lidh traditën teknike me një gjuhë bashkëkohore dhe e bën identitetin të dallueshëm e të qëndrueshëm.

#### **Mendoni se i ka rezistuar kohës dhe qëllimit të saj?**

Po, logoja është konceptuar për t’i rezistuar kohës. Ajo mbështetet në parime klasike të dizajnit – thjeshtë-



si, gjeometri dhe simbolikë të qartë – duke shmangur trendet kalimtare. Kjo e bën logon të qëndrueshme si në funksion ashtu edhe në mesazh, duke ruajtur rolin e saj identifikues edhe në afatgjatë.

#### **A përputhet me zhvillimin e së ardhmes apo ka nevojë për përmirësime?**

Logoja përputhet me vizionin e së ardhmes që u kërkua që në hapat e parë të projektit. Ajo është ndërtuar si një sistem vizual fleksibël dhe i adaptueshëm për media dhe kanale të ndryshme komunikimi, sot dhe në të ardhmen. Për Vatra-n, ndërtimi i logove që qëndrojnë në kohë është pjesë thelbësore e procesit tonë krijues. Çdo identitet zhvillohet duke marrë parasysh qasjet teknike, risitë teknologjike dhe mënyrën se si logoja funksionon në print, digital, motion dhe ambiente fizike. Çdo përmirësim i mundshëm do të jetë evolutiv dhe funksional, pasi baza konceptuale e logos është e fortë dhe e qëndrueshme.

# GJERGJ SIMAKU: SI “KRYEMINISTËR” DO TË ANULLOJA ÇDO GJË QË PRISH KOKURRENCËN

Në intervistën sikur të isha një ditë Kryeministër profesori Gjergj Simaku e vë theksin te një lider që vepron dhe jo që kërkon duartrokitje duke sjellë në vëmendje ish-kancelaren gjermane Angela Merkel. Më tej ai thekson se në do të përzgjidhte një staf profesionistësh dhe jo besnikë politik. Nga ana tjetër vecon se duhet ndryshuar dhe mënyra e financimit të fushatës, që sipas tij duhet të largohet nga mbështetja me interesa të ngushta.



## 1- Pse duhet t’ju zgjedhin ju?

Nuk e di nëse duhet, por nëse më zgjedhin, do ta pranoja sepse kam parë nga brenda se si funksionon shteti. Ajo që shfaqet publikisht është shpesh vetëm një fasadë. Realiteti është se përzgjedhja e njerëzve në administratë dhe në vendimmarrje bëhet më shumë mbi baza politike sesa mbi kompetencë. Ky hendek mes fasadës dhe realitetit nuk mbyllet me retorikë, por me rikthimin e profesionalizmit si kriter themelor i qeverisjes.

## 2- Si do t’i bënit paratë për të mbuluar fushatën tuaj elektorale?

Do ta refuzoja modelin aktual të financimit të fushatave, sepse ai krijon varësi të pashmangshme mes politikës dhe interesave private. Financimi i madh deformat përfaqësimin dhe e kthen fushatën në investim. Do të mbështetesh vetëm në kontribute të vogla, të deklaruara plotësisht dhe të verifikueshme publikisht, duke pranuar kufizimet që kjo sjell. Transparenca dhe pavarësia do të ishin më të rëndësishme për mua sesa madhësia e fushatës

## 3- Cili prej aktiviteteve tuaja do të përbënte pengesën më të madhe për stafin tuaj?

Pengesën më të madhe për stafin tim do ta përbënte kërkesa ime e vazhdueshme për argumente. Nuk më mjafton bindja formale apo referimi te zakoni; kërkoj shpjegim dhe përgjegjësi për çdo propozim. Jam i vetëdijshëm që kjo qasje mund të ngadalësojë pro-

ceset dhe të krijojë presion, por e shoh si çmim të domosdoshëm për vendimmarrje të qëndrueshme dhe të arsyetuar.

## 4- Sa informacion personal kanë të drejtë votuesit të dinë për ju?

Votuesit kanë të drejtë të dinë vetëm atë informacion personal që ndikon drejtpërdrejt në vendimmarrjen time publike dhe në ushtrimin e detyrës. Jo çdo aspekt i jetës private është interes publik. Kufiri duhet të jetë ligji dhe transparenca funksionale: çfarë ndikon në konflikt interesi, integritet dhe përgjegjësi, po; gjithçka tjetër, jo.

## 5- Cili aktivitet do të ishte problemi më i madh për truporjat tuaja?

Problemi më i madh për truporjat e mia do të ishte refuzimi i protokollit. Kam prirjen të shmang formalitetet e tepërta dhe distancën artificiale, gjë që krijon vështirësi në menaxhimin e sigurisë. E di që kjo nuk është gjithmonë e përshtatshme për funksionin, por është pjesë e mënyrës sime të të qenit dhe e raportit tim të drejtpërdrejtë me njerëzit

## 6- Cili është problemi më i madh në Shqipëri dhe si do e zgjidhni?

Problemi më i madh në Shqipëri është institucional, kulturor dhe ekonomik njëkohësisht, por rrënja e tij është ekonomike. Varfëria reale dhe pasiguria ekonomike e bëjnë qytetarin të tolerojë institucione të dobëta dhe kompromis kulturor. Pa stabilitet dhe mundësi ekonomike, rregulli shihet si luks, jo si domosdoshmëri. Zgjidhja kërkon rindër-

tim institucional dhe kulturor, por nis nga krijimi i një ekonomie që shpërblen punën, dinjen dhe korrektësinë, jo lidhjet dhe rastësinë.

## 7- Kë do të emëronit në qeverinë tuaj?

Në qeverinë time do të emëroja njerëz mbi bazën e përvojës së provuar, jo të besnikërisë politike. Përvoja në administratën publike, në sektorin privat dhe në institucione ndërkombëtare do të vlerësohej në mënyrë të kombinuar. Më shumë sesa përkatësia politike, do të kishte rëndësi aftësia për të menaxhuar procese komplekse, për të marrë vendime të arsyetuara dhe për të mbajtur përgjegjësi për rezultatet.

## 8- Shkruani titullin e lajmit të parë të madh për qeverinë tuaj.

Qeveria e re ndalon praktikat që deformat një konkurrencën dhe nis ndërtimin e një ekonomie të integruar realisht në Bashkimin Evropian.

## 9- Si Kryeministër/e i Shqipërisë, sipas cilit politikan të vdekur apo të gjallë do e modelonit veten?

Si Kryeministër do ta modeloja veten për nga qasja sipas Angela Merkel: reformuese, jo populiste, pragmatike dhe thellësisht evropiane. Jo si figurë karizmatike që kërkon duartrokitje, por si drejtuese që punon me institucione, me durim dhe me përgjegjësi, duke vendosur stabilitetin dhe rezultatet afatgjata mbi retorikën e momentit.

## 10- Cilët libra do të ishin “duhen lexuar” në administratën tuaj?

Në administratën time do të ishin “duhen lexuar” disa libra themelorë për etikën, ekonominë dhe mendimin kritik. Ndër ta, “The Road to Serfdom” i Friedrich A. Hayek, si reflektim mbi marrëdhënien mes shtetit, lirisë dhe përgjegjësisë, dhe “Thinking, Fast and Slow” i Daniel Kahneman, për të kuptuar se si paragjykimet dhe vendimmarrja e dobët ndikojnë drejtpërdrejt politikën publike. Jo si dogma, por si ushtrim mendimi.

## 11- Çgjë do të bënit të jashtëligjshme?

Do ta bëja të jashtëligjshme kapjen e institucioneve përmes emërimeve politike, informalitetin ekonomik të toleruar dhe zbatimin selektiv të ligjit. Jo si deklaratë morale, por si shkelje të rënda të rendit kushtetues dhe të funksionimit normal të shtetit. Këto deformime prodhojnë pabarazi, pasiguri dhe mosbesim dhe duhet të trajtohen si rrezik sistemik, jo si devijime të përkohshme.

## 12- Kë do preferonit si President dhe Kryetar Parlamentit?

Si President do të preferoja një figurë me profil karizmatik dhe gjerësisht të pranuar, që mishëron unitetin dhe dinjitetin institucional të shtetit. Ndërsa si Kryetar Parlamentit, një person të drejtë dhe luftarak për parlamentarizmin, që mbron rregullat, debatin real dhe rolin kushtetues të Kuvendit, edhe kur kjo është e pakëndshme për shumicën.